



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



Date: 26/08/2024
Nr : 64/2024

Mbështetur në nenin 25, paragrafi 8 i LPP-së Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Bordi i KRPP-së bazuar në kërkesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për Anulimin e Certifikatës Profesionale për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit Publik të Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës, znj. Ganimete Mahmuti, merre këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET PJESERISHT**, si e bazuar kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP-së) e datës 04.07.2024, e parashtruar në Bordin e KRPP-së, për anulimin e certifikatës profesionale për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit Publik të Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës znj. Ganimete Mahmuti.
- II. **ISHQIPTOHET VËREJTJE ME SHKRIM**, Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës, znj. Ganimete Mahmuti..

A R S Y E T I M I

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), bazuar në **Nenin 91.1 pika b** të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ka parashtruar kërkesë pranë Bordit të KRPP-së, për anulimin e certifikatës profesionale për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit Publik të Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës znj. Ganimete Mahmuti.

Kërkesa në fjalë është parashtruar me arsyetimin se e lartë përmendura nuk ka respektuar dispozitat ligjore të legjislacionit për Prokurim Publik për aktivitetin e Prokurimit, **“Furnizim me tabela digjitale mësimore”**, me numër të prokurimit **“615-23-759-1-1-1”** duke mos e dorëzuar tek Operatori Ekonomik i caktuar kërkesën për zgjatje të validitetit të ofertës.

Kryetari i KRPP-së, pas pranimit të kërkesës së OSHP-së, me vendimin e datës 10.07.2024, nr.50/2024, i ndryshuar në pikën 1 lidhur me Kryesuesin e Komisionit me vendim të dt.18.07.2024 nr.55/2024, ka caktuar komisionin për shqyrtimin e kërkesës së datës 04.07.2024, të parashtruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për anulimin e certifikatës profesionale të Prokurimit për znj. Ganimete Mahmuti, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Podujevës.

Komisioni i formuar me vendim nga Kryetari i KRPP-se për shqyrtimin e kërkesës së OSHP-së, me datën: 08.08.2024 ka mbajtur takimin e parë, ku ka analizuar lëndën lidhur me këtë kërkesë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dëshmimeve të ofruara nga Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP-së), komisioni në fjalë për trajtimin e kërkesës në fjalë ka konstatuar se :

Për aktivitetin e Prokurimit: “*Furnizim me tabela digjitale mësimore*”, me numër të prokurimit: “615-23-759-1-1-1”, me datën 10.02.2023, Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 300,000.00 €.

Me datën 07.03.2024 është publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, njoftimi për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për Kontrate OE “Bak Ing” SHPK.

Me datën 09.03.2024 OE “Solvit” SHPK, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK.

Me datën 14.03.2024 AK e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Solvit” SHPK.

Me datën 12.03.2024 kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kundër vendimit për dhënie të kontratës ka parashtruar edhe OE – NTSH “Artech” e cila është refuzuar si e pabazuar nga AK në ditën 13.03.2024.

Te pakënaqur me vendimin e AK-se që të dy OE-të kanë parashtruar ankesë në OSHP.

OE “Solvit” SHPK me datën 24.03.2024 kurse OE NTSH “Artech” me datën 25.03.2024.

Duke qenë se të dy këto ankesa kanë qenë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues, OSHP ka vendosur që ti bashkojë të dy ankesat dhe ti trajtoj si rast i unifikuar sipas Rregullores së punës së OSHP-së.

Lidhur me këtë, OSHP me datën 07.06.2024 ka nxjerr vendim të fundit sipas të cilit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e OE – “Solvit” SHPK, kurse vendimin e AK- Komuna e Podujevës e ka anuluar në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Ndërsa, ankesën e OE-NTSH “Artech” e ka hedhur poshtë pasi që e ka konsideruar si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së. Gjithashtu ka kërkuar edhe të iniciohet procedura për marrjen e certifikatës ndaj ZPP përgjegjës të aktivitetit të prokurimit të lartcekur.

Me qëllim të ndërmarrjes së hapave të mëtutjeshëm dhe marrjes së një vendimi sa më të drejtë, komisioni ka vendosur që në bazë të nenit 94.1 pika b të Rregullores për Prokurim Publik, me datë 08.08.2024 ta ftoj në takim Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit të AK- Komuna e Podujevës znj. Ganimete Mahmuti si dhe ka kërkuar që në formën elektronike të i dërgoj të gjitha sqarimet dhe argumentet e tij sa i përket çështjes konkrete.

Në takimin e mbajtur me znj. Mahmuti, ajo ka shpjeguar gjithë kronologjinë e këtij aktiviteti të prokurimit ku nder të tjera ka sqaruar:

Gjatë fazës kur kjo lëndë ka qenë në ankesë në OSHP Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka dalë në pension dhe nga data: 11.08-2023 – 31.12.2023 unë kam qenë e autorizuar për nënshkrimin e dokumentacionit dhe kryerjen e detyrave të zyrtarit përgjegjës të prokurimit.

Më datë: 23.08.2024 kemi pranuar vendimin e OSHP-së nr: 2023/0438, Me këtë rast ju sqaroj se në vendimin 2023/0438 janë të cekura të gjitha çështjet e pretenduara andaj kjo lëndë është kthyer në rivlerësim dhe përsëri nga ana e komisionit ka ardh një raport i njëjtë për anulim të aktivitetit me datë: 20.09.2023 sepse nuk janë plotësuar specifikat teknike siç janë kërkuar.

Më datë: 09.11.2023 kemi pranuar vendimin nr: 2023/0763

Me të pranuar vendimin kemi formuar komisionin e vlerësimit. Vlen të theksohet se gjatë kësaj kohe sa ka qenë lënda në rivlerësim me datë: 20.12.2023 të gjithë OE pjesëmarrës ju është kërkuar përmes e-mailit zgjatja e validitetit të ofertave dhe sigurimit dhe rezultoi se OE SOLVIT SH.P.K. nuk ka pranuar një kërkesë të tillë ku më vonë është vërejtur se ka pas gabim në server por një gjë të tillë unë si përgjegjëse e prokurimit nuk e kam vërejt sepse nga volumi i punëve dhe përgjegjësive në fund të vitit nuk jam marrë vetëm me këtë kërkesë dhe asnjë nga zyrtarët e prokurimit nuk më ka njoftuar për një gjë të tillë sepse deri me datë: 31.12.2023 edhe zyrtar të tjerë të prokurimit kanë pas qasje në e-mailin e prokurimit. (për emailin e dështuar më ka njoftuar menaxheri i prokurimit i tanishëm, pasi që unë kam qenë në pushim për një periudhë të gjatë),

Unë nga data 03.01.2024 deri me 02.05.2024 kam qenë në pushim pa pagesë për shkaqe shëndetësore.

Ajo vazhdon duke sqaruar se, gjatë kësaj kohe janë marre edhe dy vendime tjera nga AK, njëri i datës: 07.03.2024 ku AK ka propozuar për dhënie një OE pjesëmarrës dhe prape lënda ka shkuar në OSHP, ku e njëjta (OSHP) në vendimin e fundit ka kërkuar nga KRPP të ndërmerren masa ndaj meje.

Znj.Mahmuti përmes emailit ka bashkëngjitur edhe të gjitha dëshmitë lidhur me këtë Procedurë Prokurimi.

Sipas të dhënave të lartë cituara dhe gjendjes faktike, komisioni ka konstatuar se :

Pas Publikimit të Njoftimit për Kontratë me datë 13.02.2023 dhe hapjes së ofertave me datë 18.04.2023, AK- Komuna e Podujevës , ka bërë vlerësimin e ofertave dhe me datë 13.06.2023 ka vlerësuar se asnjë OE pjesëmarrës nuk i plotëson kushtet e tenderimit dhe kështu ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Pas parashtrimit të disa kërkesave për rishqyrtim dhe refuzimit të tyre nga AK- Komuna e Podujevës, lënda ka shkuar në OSHP, ku e njëjta me vendimin e datës 23.08.2023 lëndën e ka kthyer në Rivlerësim. Edhe pas kthimit të lëndës në rivlerësim AK – Komuna e Podujevës me datën 20.09.2023 ka marrë vendim për anulim të aktivitetit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me datën 09.11.2023 OSHP, lëndën e kthen prape në rivlerësim duke dhënë rekomandimet e saj. Gjatë kësaj kohe sa ka qenë lënda në rivlerësim, të gjithë OE-ve i është kërkuar përmes e-mailit zgjatja e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit. Sipas të dhënave rezultoi se OE “Solvit” shpk nuk e ka pranuar kërkesën e tillë dhe e-maili i njëjtë është kthyer prapa tek AK duke mos mbërritur kurrë tek OE ankues që d.m.th se teknikisht domenet e AK-se dhe OE –së nuk kishin komunikuar për një kohë dhe si rezultate e-maili i dërguar nga AK nuk ka arritur tek domeni i OE-së dhe gjithmonë ka kthyer prapa përgjigje për mos dërgim të suksesshëm.

Sipas Raportit të Rivlerësimit të datës 29.02.2024 dhe vendimit të datës 07.03.2024 AK-Komuna e Podujevës e ka shpallur një OE fitues “Bak-Ing” shpk ndërsa OE-në ankues “Solvit” shpk, e ka eliminuar si të papërgjegjshëm si dhe për arsye të mos zgjatjes së Validitetit të ofertës. Edhe pas këtij vendimi, AK-Komuna e Podujevës ka pranuar kërkesa për rishqyrtim të cilat i ka refuzuar dhe si rezultat lënda ka shkuar prapë në OSHP.

OSHP me datën 07.06.2024 ka marrë Vendim për anulimin në tërësi të aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme si dhe ka iniciuar kërkesën për marrje të masave ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Si rrjedhojë e gjithë kësaj, komisioni ka vlerësuar se:

OSHP kërkesën për anulim të certifikatës ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit e ka bërë me arsyetimin se e njëjta nuk e ka dorëzuar kërkesën për zgjatje të validitetit të ofertës tek Operatori Ekonomik pjesëmarrës.

Një shkelje e tillë sipas nenit 97 pika f e **Rregullores Nr.001/2022** për Prokurim Publik konsiderohet “Shkelje e Rëndë”.

Mirëpo, Neni 30.4 i **Rregullores Nr.001/2022** për Prokurim Publik përcakton:

*30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. **Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)***

Sipas nenit të lartëcituar thuhet se “**Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem**”, një veprim të tillë ZPP e ka kryer dhe këtë e ka dëshmuar me kërkesën për zgjatje të validitetit të datës 20.12.2023 të cilën ka tentuar ta dërgoj, mirëpo kjo kërkesë nuk ka mbërritur tek OE dhe është kthyer prapa.

Ndërsa, verifikimin që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit, ashtu siç përcaktohet me nenin 30.4 “**(është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)**”, ZPP nuk e ka bërë, pasi që sipas këtij neni Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet të sigurohet dhe të verifikoj që të gjithë OE pjesëmarrës kanë pranuar kërkesën për zgjatje të validitetit.

Gjithashtu edhe sipas Raporteve të Vlerësimit, shihet se OE “Solvit” ka dal i papërgjegjshëm që do të thotë se në tri raste Komisioni i vlerësimit e ka shpallur si të papërgjegjshëm, si rrjedhojë mos zgjatja e validiteti nuk ka qenë e vetmja arsye që e ka paralizuar OE.

Si rezultat i këtyre të gjeturave komisioni me shumicë votash ka vendosur që Bordit të KRPP-së ti propozoj që ZPP-së së AK-Komuna e Podujevës ti Shqiptohet masa “Pezullim” i certifikatës së prokurimit për një periudhë 4 mujore”.

Pas një trajtimi dhe analizimi më të gjerë të kërkesës dhe Raportit të Komisionit, Bordi i KRPP-së është pajtuar me të gjeturat e komisionit duke e konsideruar Raportin edhe si një raport të detajuar, mirëpo lidhur me masën disiplinore ka vendosur që ZPP se AK Komuna e Podujevës ti shqiptoj “**Vërejtje me shkrim**”, duke arsyetuar:

Siç shihet, edhe nga kronologjia e raportit ky proces i prokurimit ka pasur një stërzgjatje, hapja e ofertave është bërë me 18.04.2024 ndërsa OSHP-ja me date 07-06-2024 ka marrë vendim për anulim në tërësi të Aktivitetit të Prokurimit.

Gjate kësaj periudhe ka pasur ndryshim të Zyrtareve Përgjegjës të Prokurimit, siç shihet nga raporti znj. Ganimete Mahmuti me 11-08-2023 deri 31-12-2023 ka ushtruar detyrën e ZPP, ndërsa me 03-01-2024 deri me 02.05.2024 ka qenë në pushime pa pagesë për shkaqe shëndetësore. Duke qenë se një veprim është ndërmarre nga ZPP, pasi që kërkesën për zgjatje të validitetit e ka përgatitur dhe ka tentuar ta dërgoj tek *OE SOLVIT SH.P.K*, mirëpo e-maili nuk ka arritur të shkojë tek OE për arsyet që janë sqaruar në Raportin e Komisionit dhe duke qenë se OE në fjale nuk është refuzuar vetëm për shkak të validitetit por ka qenë i papërgjegjshëm edhe në aspekte tjera, do

te thotë se mos zgjatja e validiteti nuk ka qenë i vetmi shkaktar që e ka paralizuar OE, po ashtu Zyrtarja detyrën e ZPP e ka ushtruar vetëm për një periudhe të shkurtër kohore. Duke u mbështetur në rrethanat e lartcekura Bordi i KRPP-se vendosi që Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të Komunes së Podujevës znj.Ganimete Mahmuti ti shqiptoj masën Vërejtje me shkrim

Bordi i KRPP-së, në mbështetje të nenit 25, paragrafit 8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në Raportin e Komisionit dhe rrethanat e cekura si më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ne rasti të përsëritjes së udonijve shkelte të LPP-së apo legjislacionit sekondarë, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Komunes së Podujevës të marrë masa udhëzuese në fjalë në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë.

z. Osman VISHAJ - Kryetar

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura, (Pala e atakuar) mundë të ankohet sipas Nenit 25 paragrafi 8 i LPP-së kurse (OSHP-ja) në gjykatën kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin, në pajtim me rregullat e zakonshme për shqyrtimin gjyqësorë të vendimeve administrative.

Vendimi t'u dërgohet:

- 1X1 Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP-së)
- 1X1 Bordit të KRPP-së
- 1X1 Zyrtarit Kryesor Administrativ(ZKA)
- 1X1 Palës
- 1X1 Arkivës së KRPP-së